



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha raportuese	Maj 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Lindita Hajdari- Salihi

- 1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes / ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.*

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga Drejtoria dhe Komuna. Drejtoria e Kulturës dhe institucionet varëse, kanë realizuar planin operativ të punës dhe kanë pasur angazhime të tjera sipas nevojës.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Realizimi i planit operativ të punës dhe angazhime të tjera sipas nevojës së DKRS-së;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përgatitja dhe mbledhja e materialeve për tenderin “Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore (shtëpi banimi Sali Savqi dhe Shkolla e parë shqipe).
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativen e qytetit të Prishtinës.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”:

- Vazhdimi i punës së punëtorëve të bibliotekës, praktikanteve dhe të rinjëve nga Shërbimi sprovues për futjen në katalog të librave në retrospektivë dhe përpunimi fizik i tyre, me qëllim të funksionalizimit të Modullit të huazimit sipas planifikimit, me qëllim që të fillojë brenda këtij viti;
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;

- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
- Mbikëqyrja dhe angazhimi i të rinjve nga Shërbimi sprovues me punë të detyrueshme në bibliotekë (përpunimi fizik i librit);
- Trajnimi dhe mbikëqyrja e praktikantëve në punët profesionale të veprimtarisë bibliotekare;
- Vizita të rregullta të institucioneve shkollore dhe parashkollore.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Zhvillimi i takimeve dhe provave të rregullta në të gjithë sektorët;
- Përfundimi i punimeve, izolimi i kulmit të sallës së korit;
- Pjesëmarrje të grupit të valltarëve në Festivalin në Kishnicë;
- Rregullimi i pjesshëm i ndriçimit në objektet e QKF-së;
- Pjesëmarrje në Festivalin në Rahovec.

Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona":

- Planifikohen 8 shfaqje të rregullta në skenën e teatrit të kukullave, të shtunave, në orën 12:00 dhe 13:00;
- Planifikohen 2 shfaqje të organizuara, si dhe 12 aktivitete të tjera sipas kërkesave të klientëve (Festa e abetares, SHFMU "E. Gjika" në gjuhët shqipe dhe turke;
- Dita e shkollës, SHFMU "Z. Hajdini", aktivitete në kuadër të Festivalit "Fem Art" të organizuar nga OJQ "Artpolis";
- Do të realizohen repriza të shfaqjeve "Prehri i Gjyshit", 4 herë, " Kësulëkuja", 2 herë, "Minuku lozonjar", 2 herë, " Mustaqoshi larosh", " Goni trazovaçi", ndërsa në skenën për të rritur do të realizohen Shtëpia e saj prej letre", "Vajza me ndjenjën e mrekullueshme", do të realizohet punësoria " Daullet si mjet rezistence", si dhe do të realizohen provimet e Fakultetit të Arteve;
- Në kuadër të aktiviteteve promovuese do të realizohet një takim me 50 fëmijë nga Prishtina, Mitrovica dhe Ferizaj, të cilëve Valdet Rama do t'u mbajë një ligjëratë shkollore për teatrin dhe si realizohet një shfaqje teatrale;
- Gjatë muajit prill 2018, do të vazhdojnë provat për realizimin e shfaqjes së gjashtë nga subvencionet "Medea ose arti i egzilit" në menaxhimin e Alban Beqirajt;
- Në skenën për të rritur do të realizohen 3 repriza të shfaqjes "Barbara".

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;

- Realizimi i planit operativ të punës, si dhe angazhime të tjera sipas nevojës së DKRS-së;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përgatitja e deklaratës për tenderin “Konkurs projektimi për hartimin e projektit “Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish- Kadastrit, Prishtinë;
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativën e qytetit të Prishtinës;
- Përgatitja e deklaratës për tenderin “Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore (Shtëpi banimi Sali Savqi dhe Shkolla e parë shqipe;
- Realizimi i programit të rregullt të Kino Armatës, duke filluar çdo ditë nga ora 19:00;
- Vazhdimi i punëve për rrugën model;
- Realizimi i punëtorisë, së bashku me palët e interesit, në bashkëpunim me Swiss Kontakt për “Përpilimin e Strategjisë së turizmit për komunën e Prishtinës”;
- Takim i stafit për rishikimin e buxhetit;
- Takimi i grupit punues të anëtarëve të komisionit, në bazë të Vendimit nr. 14-020/04-0111547/18 dt.11.05.2018, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për zhvillimin e diskutimit publik të Rregullores për ndarje të subvencione. U caktua data me 12 qershor të mbahet dëgjimi publik;
- Vizita dhe takime të rregullta lidhur me objektet e trashëgimisë Kulturore;
- Janë pranuar gjithsej 66 lëndë për kulturë, rini dhe sport, ku 44 prej tyre janë miratuar dhe të tjerat janë në proces;
- Takimi i ekipit teknik për sallën koncertale.

Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”:

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
- Takimet e rregullta dhe përgatitja e aktiviteteve për manifestimin “Prishtina lexon”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturë dhe organizatave tjera të angazhuara;
- Më 28 maj, OJQ “Etea” hapi festivalin “Prishtina lexon” në degën përkujtimore të bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, me aktivitetin “Nata e letërsisë dhe poetikës”;
- Më 29 maj, në sallën e bibliotekës “Hivzi Sulejmani” u mbajt debati - Stefan Zweig: “Artisti dhe humanisti nga Virtualsi Sophists”, në bashkëpunim me Etea, Termokiss dhe biblioteka “Hivzi Sulejmani”.
- Më 31 Maj, shfaqja e filmit “STALKER”, Virtual Sophists, Etea, Termokiss
- Përgatitjet për aktivitetet e 1 Qershorit;
- Gjatë muajit maj, ka pasur vizita të organizuara në bibliotekë në këndin e fëmijëve nga instiucione parashkollore dhe nga shkollat e qytetit;

- Trajnimi dhe mbikëqyrja e tri praktikanteve në punët profesionale të veprimtarisë Bibliotekare;
- Mbikëqyrja dhe angazhimi i të rinjve nga Shërbimi Sprovues me punë të detyrueshme në bibliotekë (përpunimi fizik i librit).

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Mbatja e orëve të rregullta në të gjithë sektorët e QKF-së;
- Pjesëmarrja në Festivalin mbarëkombëtar "DAMASTION FOLK 2018", në Kishnicë, ku valltarët e QKF së u shpërblyen me çmimin "Valltarët më të mirë";
- Realizimi i punëtorisë nga Klubi i Ambasadorëve të Rinj, me temë "Vullnetarizmi" në kuadër të festës së 9 majit - Ditës së Evropës.

Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona" - shfaqje:

- Janë realizuar 8 shfaqje të rregullta në skenën e teatrit të kukullave, çdo të shtunë, në orën 12:00 dhe 13:00;
- Janë realizuar 2 shfaqje të organizuara në skenën e teatrit të kukullave;
- Gjatë muajit maj 2018, janë realizuar reprizat e shfaqjeve "Prehri i gjyshit", "Kësulëkuqja", "Minuku lozonjar", "Mustaqoshi larosh", "Goni trazovaçi";
- Në skenën për fëmijë, janë realizuar gjithsej 10 shfaqje dhe janë shikuar nga 598 shikues;
- Gjatë muajit maj 2018, kanë vazhduar provat për realizimin e shfaqjes së gjashtë nga subvencionet "Medea ose arti i egzilit" në menaxhimin e Alban Beqirajt;
- Në skenën për të rritur, është realizuar 1 reprizë e shfaqjes "Barbara" dhe është shikuar nga 60 shikues;
- Janë realizuar 5 programe vetanake të nxënësve të SHFMU "Elena Gjika" të Prishtinës, dita e shkollës e SHFMU "Zenel Hajdini";
- Gjatë muajit prill, janë realizuar një numër i madh i provave për realizimin e shfaqjeve;
- Gjithashtu janë realizuar edhe dy performanca në kuadër të festivalit "Femart" (Shfaqja e baletit "Shtëpia e saj prej letre", si dhe "Vajza me ndjenjën e mrekullueshme");
- Në kuadër të punës së lejuar nga DKRS për grupin "Artpolis", janë realizuar edhe provat e performancës "Trojanët".

Arkivi Komunal:

- Gjatë muajit maj janë pranuar gjithsej 41 kërkesa, të cilat kanë marrë përgjigje. Kërkesat kryesisht kanë ardhur nga punëtorët nga disa ndërmarrje shoqërore.

- Është duke u punuar rreth rregullimit të lëndës arkivore të njësisë organizative “Banka dhe Financa”, të cilat pas klasifikimit i janë ndarë punëtorëve për t’i rregulluar në mënyrë profesionale.

3.AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Tenderi “ Ofrimi i shërbimeve për organizime dhe manifestime kulturore, rinore dhe sportive”, është në proces;
- Tenderi “Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore (Shtëpi banimi Sali Savqi dhe Shkolla e parë shqipe)” është në proces;
- Tenderi “ Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish – Konsullatës dhe objektet përcjellëse”, është në proces;
- Tenderi - Konkurs projektimi për hartimin e projektit “Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit, Prishtinë”, është në proces;
- Tenderi “Furnizimi dhe montimi i totemave, sinjalizuesve turistikë”, është në proces;
- Tenderi “ Intervenime emergjente në mbrojtje të ndërtesave të trashëgimisë kulturore” , është në proces;
- Tenderi “ Furnizim me libra”, është në proces;
- Tenderi” Furnizimi me pajisje elektronike, mekanike (DODONE)”, është në proces;
- Tenderi “Implementimi i standardit për siguri dhe mbrojtje të lëndës arkivore”, është në proces;

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Përgatitje e valltarëve për pjesëmarrje në Festivalin në Rahovec;
- Bashkëpunimin mes QKF-së dhe Institucionit për punë me rini nga Cyrihu: Offene Jugendarbeit Zurich (www.oja.ch).

Biblioteka e qytetit “Hivzi Sulejmani”:

- Vizita të rregullta të institucioneve shkollore dhe parashkollore;
- Planifikimi dhe përgatitjet për funksionalizimin e Modullit të huazimit.

4.1.3 Takimet me palë

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Organizimi dhe koordinimi i takimeve të rregullta për drejtorin, sipas kërkesave të qytetarëve.

5. Takimet me institucione të tjera

-Kontakte me DA-në rreth organizimit të shkollave për pjesëmarrje në aktivitetet “ Prishtina lexon”;

-Kontakte me bibliotekën “Hivzi Sulejmani” rreth organizimit të ndarjes së shpërblimeve dhe pjesëmarrjes së Korit të QKF-së.

6. Diskutime publike/takimet me qytetarë

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

6.1.2Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

7. Takime të tjera

8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

Sektori i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit

- Numri i vogël i stafit në Sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit.

Arkivi i Qytetit

Mungesa e punonjësve në Sektorin e rregullimit.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

Mungesa e punonjësve për punën me lexues dhe mirëmbajtje të objektit.

9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.*

Sektori i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit.

Krijimi i mundësive për shkëmbim të përvojave të punës me vendet në rajon, si dhe vizita studimore për fushën e Kulturës.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.

Spektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Realizimi i planit operativ të punës, si dhe angazhime të tjera sipas nevojës së DKRS së;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përgatitja e kontratave për përfituesit e subvencioneve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Vazhdimi i punës së grupit punues për narrativen e qytetit të Prishtinës;
- Pranimi i raporteve narrative dhe financiare të projekteve të subvencionuara;
- Koordini, përgatitjet e punëve paraprake lidhur me marrëveshjen e mirëkuptimit për themelimin e muzeut "Shtëpi - Shkolla";
- Koordinimi, përgatitjet e punëve paraprake lidhur me marrëveshjen e mirëkuptimit për fondacionin "Ibrahim Kodra".

Biblioteka " Hivzi Sulejmani":

- Aktivitetet e bibliotekës për manifestimin tradicional "Prishtina lexon";
- Regjistrimi falas, më 1 qershor, në bibliotekën në lagjen "Dardania" dhe në degët e saj;
- Shpallja e lexuesve të dalluar që planifikohet të mbahet në sheshin "Zahir Pajaziti";
 - Krijimi i librit të preferuar- aktivitet me lexuesit e bibliotekës, që do të mbahet në Degën Përkujtimore;
 - Vazhdimi i punës së punonjësve të bibliotekës, praktikantëve dhe të rinjve nga Shërbimi sprovues për futjen në katalog të librave në retrospektivë dhe përpunimi fizik i tyre, me qëllim të funksionalizimit të Modullit të huazimit sipas planifikimit, me qëllim që të fillojë brenda këtij viti;
 - Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
 - Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
 - Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
 - Huazimi i librit;
 - Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore;
 - Mbikëqyrja dhe angazhimi i të rinjve nga Shërbimi Sprovues me punë të detyrueshme në bibliotekë (përpunimi fizik i librit);
 - Trajnimi dhe mbikëqyrja e tri praktikanteve në punët profesionale të veprimtarisë bibliotekare;
 - Vizita të rregullta të institucioneve shkollore dhe parashkollore.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Rregullimi i ndriçimit të brendshëm në zyrat e QKF së;
 - Pjesëmarrje në Festivalin në Rahovec- grupi i valltarëve;
 - Përgatitjet për realizimin e aktiviteteve " Prishtina lexon", Ambasadorët, Kori, valltarët.
- Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona":**
- Planifikohen 6 shfaqje të rregullta në skenën e teatrit të kukullave, të shtunave në orën 12:00 dhe 13:00;
 - Planifikohen shfaqje të organizuara në skenën e teatrit të kukullave;
 - Më 13 qershor 2018, planifikohet realizimi i shfaqjes premierë nga subvencionet për vitin 2017, "Medea ose arti i egzilit" në menaxhimin e Alban Beqirajt.
 - Më 14 qershor, repriza e parë, ndërsa repriza e dyte do të realizohet më 28 ose 29 qershor;
 - Me lejen DKRS-së dhe Këshillit drejtues, gjatë muajit qershor do të realizohen disa aktivitete shtesë, provime të Akademisë së Arteve, shfaqje provimi- Bashkim Ramadani, Astrit Bytyqi, Fata Hyseni, Habib Hajzeri ("Lugu i Besës", shfaqje e cila i kushtohet një vajze dhjetëvjeçare të vrarë në luftë) më 11.06.2018, ora 16:00; shfaqja e provimit të Fata Hysenit "Peroni i trembëdhjetë" më 11.06.2018, në orën 13:00.
 - Dita e Kopshtit "Dea", "Spelling Bees" të Kurseve Britanica;
 - Më 18 qershor 2018, do të realizohet programi i kolegjit "Universum";
 - Më 26 qershor 2018, do të realizohet koncerti i kursit të muzikës "Okarina";
 - Shfaqjet e fëmijëve, pritet t'i vizitojnë një numër më i madh i fëmijëve në formë të organizuar, gjë që do ta plotësonte numrin e shikuesve të cilët në këtë kohë janë të pakët;
 - Në bashkëpunim me Festivalin e Monodramës "Mono Akt", më 19 qershor do të shfaqet një shfaqje në skenën e TQP "Dodona";
 - Më 22 qershor 2018, do të realizohet programi i kopshtit "Fillesa", me fillim në ora 18:00;
 - Duke qenë se formimi i Këshillit drejtues është vonuar shumë, do t'i propozohet Këshillit që Festivali Tradicional i Teatrove të Kukullave të realizohet në muajin nëntor, e jo në shtator sikur është menduar më parë;
 - Duke qenë se muaji qershor është muaji i Ramazanit, del se festa e Bajramit bie ditën e premte, më 15 qershor 2018, shfaqje nuk do të ketë ditën e shtunë, më 16 qershor, ditën e dytë të festës së Bajramit.

Arkivi i qytetit

- Planifikohet që gjatë muajit qershor të vazhdohet me punën dhe rregullimin e materialit të njesisë organizative 11 "Banka dhe Financa".

TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

Përpilimi i planit buxhetor për të gjitha aktivitetet kulturore për vitin 2018, si dhe plani buxhetor për festivalin “Ylberi i Prishtinës”.